

**TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**  
**BULETINI I DYTË MJEDISOR DHE SOCIAL**



## tabela e përmbajtjes

MESAZH NGA DREJTORJA E PËRGJITHSHME EKZEKUTIVE	3
HYRJE	4
ÇFARË ËSHTË E RE NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS?	5
SISTEMI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT DHE CILËSISË	6
MENAXHIMI I MBETJEVE	7
MENAXHIMI I CILËSISE SË AJRIT	8
MENAXHIMI I UJIT	8
ZHURMA	9
MJEDISI NATYROR	10
NDËRGJEGJËSIMI DHE TRAJNIMI MBI MJEDISIN DHE CILËSINË	11
SHËNDETI DHE SIGURIA	11
GATISHMËRIA DHE REAGIMI NDAJ EMERGJENCAVE	12
POLITIKA KUNDËR DUHANIT	15
NISMAT SOCIALE	15
TË DHËNAT KRYESORE	15



Zj. Andrea Gebbeken  
Drejtoresh e Përgjithshme Ekzekutive  
Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës

## MESAZH NGA DREJTORJA E PËRGJITHSHME EKZEKUTIVE

Të dashur lexues,

Ky vit ka qenë tejet i rëndësishëm për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës (TIA). Më 21 mars 2007, ne festuam hapjen e terminalit të ri të pasagjerëve, një vepër infrastrukturore arti që ofron standardet më të larta të operimit dhe shërbimit në dobi të pasagjerëve. Fillimi i veprimtarisë në terminalin e ri ka shënuar fillimin e një epoke të re në transportin ajror në Shqipëri.

TIA aktualisht menaxhon lëvizjet e afërsisht një milion pasagjerëve dhe më shumë se dy mijë tonëve mallra në vit. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2007, nëpërmjet aeroportit udhëtuan afërsisht 850,000 pasagjerë, duke shënuar kështu një rritje prej 21 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dhe këto shifra vazhdojnë të rriten.

Çështjet e mjedisit në aeroport janë adresuar me kujdes dhe përkushtim. TIA është plotësisht e vetëdijshme për përgjegjësitë e veta sociale dhe po bën përpjekje të mëdha për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës për banuesit e zonës, duke respektuar mjedisin dhe duke ndërmarrë projekte të rëndësishme zhvillimi. Kështu, TIA ka investuar në përgatitjen e një plani zhvillimi për kalanë e Prezës dhe rrethinat përreth aeroportit. Gjatë periudhës që nga dhënia e koncesionit, ka pasur një pjesëmarrje të vazhdueshme të autoriteteve lokale në takimet e mbajtura për të diskutuar çështje me interes të përbashkët, si zhvillimi ekonomik i zonës dhe menaxhimi i mjedisit.

Një numër veprimtarish të rëndësishme së veçantë, jo vetëm për aeroportin, por gjithashtu për komunitetet lokale dhe gjithë Shqipërinë kanë ndodhur në TIA, përfshirë këtu edhe vizitën e parë në vend nga një president në detyrë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Një dialog i vazhdueshëm me palët e interesuara dhe publikun e gjerë është vendosur dhe po ruhet. Për më tepër, faqja e internetit e TIA-s ofron informacionin thelbësor për publikun si dhe mundësinë për reagime dhe komunikim me aeroportin. Në mirëpresim komentet, opinionet dhe sugjerimet që të mund të përmirësojmë edhe më tej paraqitjen tonë si dhe cilësinë e shërbimeve.

Buletini i dytë Mjedisor dhe Social i informon lexuesit mbi zbatimin efikas të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor dhe Cilësisë në TIA. Në ndjekjen e kësaj praktike një vëmendje e veçantë i kushtohet sfidave më të fundit, si ndërtimi dhe shfrytëzimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, si dhe vënia në zbatim e koncepteve të menaxhimit të mbetjeve që synojnë zvogëlimin e tyre përmes riciklimit. Gjithë këto zhvillime të suksesshme tregojnë përkushtimin e TIA-s në drejtim të mbrojtjes së mjedisit.

Përmes këtij botimi të dytë të Buletinit Mjedisor dhe Social, ne përgëzojmë gjithë anëtarët e komunitetit të aeroportit për këto dy vite të suksesshme në çështjet e mjedisit dhe ato shoqërore. Gjithashtu, une shpreh urimet e mia personale për më shumë vite suksesi në TIA.

Sinqerisht juaja,

## HYRJE

Zhvillime të rëndësishme që nga botimi i parë:

- a) hapja e terminalit të ri të pasagjerëve si dhe e mjediseve të tjera më 21 mars 2007
- b) krijimi dhe zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe të Cilësisë që përfshin:
  - zhvillimin e Politikës së Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë
  - zhvillimin e Politikës së Cilësisë
  - hartimin e Planit Pesëvjeçar të Veprimit Mjedisor, Shëndetësor e Sigurisë dhe atij Social
  - aprovimin e Manualit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë
  - zhvillimin e manualeve dhe procedurave për menaxhimin e mjedisit dhe cilësisë
  - ngritjen e Departamentit të Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë
- c) prezantimi i sistemit të menaxhimit të mbetjeve
- d) monitorimi i cilësisë së ajrit
- e) menaxhimi dhe testimi i cilësisë së ujit
- f) zbatimi i shërbimeve të shkrirjes së akullit që respektojnë mjedisin
- g) monitorimi i zhurmës
- j) kujdesi për peizazhin dhe gjelbërimin
- k) trajnimi dhe ndërgjegjësimi për mjedisin dhe cilësinë
- l) përgatitja dhe miratimi i Planit të Emergjencave në aeroport
- m) zbatimi i politikave kundër pirjes së duhanit
- n) përgatitja e planit turistik të zhvillimit për Prezën

Nga muaji prill 2005, TIA menaxhohet nga kompania private Tirana International Airport SHPK (më parë e njohur si Tirana Airport Partners) me aksionerë të saj HOCHTIEF Airport (HTA), DEG Deutsche Investitions und Entwicklungsgesellschaft dhe Albanian-American Enterprise Fund (AAEF). Financimi i këtij investimi në vlerën prej 50 milionë Euro, është realizuar nga EBRD si huadhënësi kryesor, mbështetur nga ABA, Alpha Bank dhe DEG.

HOCHTIEF Airport (HTA) përmbledh aktivitete aeroportuale të Grupit HOCHTIEF dhe është një nga menaxhuesit e pavarur, më të mëdhenj të botës për aeroportet. Duke qenë një ofrues ndërkombëtar i shërbimeve të ndërtimit, HOCHTIEF projektton, financon, ndërton dhe drejton një numër të madh projektsh komplekse.

Deutsche Investitions-und Entwicklungsgesellschaft, anëtar i Grupit Bankar të KfW-së, për më shumë se 40 vjet, ka financuar dhe strukturuar investimet e ndërmarrjeve private në vendet në zhvillim dhe tranzicion. Ai është një nga institucionet financiare më të mëdhenj të Europës për promovimin e sektorit privat.

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (AAEF) është themeluar nga Qeveria Amerikane me qëllimin kryesor mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat në Shqipëri. Ai iu ofron asistencë financiare dhe menaxhuese kompanive private shqiptare.

## ÇFARË ËSHTË E RE NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS?

**Hapja e terminalit të ri të pasagjerëve** i projektuar me një kapacitet fillestar vjetor prej afërsisht një milion pasagjerësh. Terminali i ri u përrua më 21 mars 2007. Kjo kryevepër infrastrukturore, e përgatitur nga arkitekti malajzian Hin Tan, ka tetë dyqane dhe duty-free, lokale, restorante dhe bar-kafe. Për zonën e nisjes dhe të mbërritjes ka një restorant, ndërkohë që në sheshin jashtë terminalit, Piazza, një bar i mbuluar, i pajisur me një fasadë tradicionale shqiptare prej guri, ofron një pamje të këndshme dhe relaksuese të ndërtesës dhe të zonës përreth. Terminali i ri përmbush kërkesat më të sofistikuar dhe përbën një kontribut të madh për transformimin e Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë.



Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës

Ndërtesa e re ofron një shumëllojshmëri shërbimesh, çka i jep të drejtën të krahasohet me shembujt më të mirë ndërkombëtarë. Ndërkohë që presin fluturimin e tyre, pasagjerët mund të kalojnë me lehtësi dhe në mënyrë të sigurt në terminalin e ri dhe të shijojnë llojshmërinë e madhe të shërbimeve të ofruara, dyqanet, si dhe ndenjëset e rehatshme në mjedisin e këndshëm.

**Ndërtimi i terminalit të ri të kargos** me infrastrukturën e import-eksportit dhe të pajisjeve doganore si dhoma frigoriferike, ftohësa dhe pajisje për ruajtjen e mallrave të rrezikshme. Kargo-ja e re ka një kapacitet prej 4,500 tonë transport mallrash në vit.

**Rruga e re hyrëse shtatë-kilometërshe.** Më 16 mars, 2007, katër muaj para afatit, u përrua rruga e re hyrëse, që e ka shkurtuar tetë kilometra distancën mes aeroportit dhe qendrës së qytetit të Tiranës. Gjithashtu, rruga e re me dy korsi, e ndriçuar mirë, ka shkurtuar në mënyrë të theksuar kohën e udhëtimit për në aeroport, duke ulur kështu nivelin e konsumimit të karburantit dhe ndotjen e mjedisit.

**Zona e re e parkimit.** Për më tepër, një rrugë e re qarkuese, 1,5 km e gjatë, dhe një zonë e re parkimi brenda aeroportit u përruan në mars 2007.



## SISTEMI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT DHE CILËSISË

Si aktori më i rëndësishëm i transportit ajror në Shqipëri, Tirana International Airport SHPK (TIA), është i përkushtuar të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme, duke siguruar veç të tjerash përfitime ekonomike dhe sociale që kontribuojnë në ekonominë lokale dhe rajonale. Në të njëjtën kohë, TIA është e përkushtuar në zvogëlimin e ndikimit në mjedis përmes adoptimit dhe vënies në zbatim të praktikave më të mira botërore.

TIA ka zhvilluar, aprovuar dhe po vë në zbatim një Sistem të Integruar Menaxhimi të Mjedisit dhe të Cilësisë (SMMC). SMMC i përmbahet Standardeve ISO 14001: 2004 dhe 9001: 2000. Ky sistem përfshin politika, procedura dhe manuale që TIA po i vë në zbatim për arritjen e objektivave të veta ndaj mjedisit dhe cilësisë.

Me qëllim që të sigurohet efikasitet në punë dhe përpikmëri në zbatimin e SMMC-së së re, më 30 janar 2007 u zhvillua një takim me pjesëmarrjen e të gjithë drejtuesve ekzekutivë dhe menaxherëve të lartë të kompanisë.

### **Departamenti i Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë**

Në qershor 2006, TIA krijoi brenda strukturës së saj organizative Departamentin e ri për Cilësinë, Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë, i cili ofron njohuritë për menaxhimin mjedisor, mbështet të gjithë departamentet e aeroportit dhe ka përgjegjësinë për përmbushjen e kërkesave mjedisore, shëndetësore, të sigurisë dhe të cilësisë.

Ky departament është përgjegjës për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë, për ruajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit në aeroport, përputhjen me standardet për mjedisin, me kërkesat për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe për matjen, monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e të dhënave lidhur me këto çështje.

Departamenti i Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë kryen kontrole mjedisore dhe inspektime të brendshme operacionale me qëllim që të garantojë përmbushjen dhe respektimin e procedurave dhe praktikave të punës. Ai, gjithashtu, ndërmerr monitorime të rezultateve të punës për të kontrolluar përmbushjen e objektivave në përputhje me Marrëveshjen e Koncesionit, Politikën e Cilësisë dhe Politikën e Mjedisit, Shëndetit dhe të Sigurisë, me qëllim kryerjen e veprimeve korrigjuese dhe parandaluese në rastet e mospërputhshmërisë.

### **Politika e Cilësisë**

Pas nënshkrimit të Politikës së Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë, TIA ka hartuar dhe nënshkruar më 12 shtator 2006, Politikën e Cilësisë, me synim arritjen e standardeve të larta ndërkombëtare të shërbimit, sigurisë dhe komoditetit duke u fokusuar tek kënaqësia e konsumatorit.

### **Plani i Veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë dhe Social**

TIA ka përgatitur dhe po përmbush një Plan Veprimi Pesëvjeçar të Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë dhe Social, i cili pasurohet çdo vit dhe plotësohet sipas Sistemit të Menaxhimit Mjedisor në përputhje me ISO 14001.

Ky plan përfshin të gjithë programet e veprimet e përshtatshme për t'u ndërmarrë, rezultatet që do të arrihen, afatet kohore dhe departamentet e personat përgjegjës për përmbushjen e tyre, për të gjitha çështjet e menaxhimit.

### **Manuali i Menaxhimit të Mjedisit dhe të Cilësisë**

TIA ka zhvilluar dhe adoptuar një Manual të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë, të miratuar në tetor 2006, për ta përdorur si një dokument drejtues dhe një mjet administrativ që të garantojë arritjen e objektivave dhe respektimin e plotë dhe të vazhdueshëm të standardeve për mjedisin, cilësinë dhe shërbimin.

## Kontratat e Shërbimit

Kontratat e Shërbimit, të përgatitura nga TIA për të gjitha organizatat dhe personat që ofrojnë shërbime në aeroport, përfshijnë standardet e specifikuar në Marrëveshjen e Koncesionit, ligjet përkatëse në fuqi, konventat dhe praktikak më të mira, deklaratën e përbushjes së standardeve dhe të tarifave të shërbimit si dhe përgjegjësitë e secilës organizatë që operon në aeroport. Kontratat, gjithashtu, përfshijnë politikat e TIA-s, politikat e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë, synimet dhe objektivat e cilësisë, udhëzuesit e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë për Palët e Treta, Standardet e Biznesit dhe Udhëzuesit e Etikës, etj.

Udhëzuesi i Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë për Palët e Treta, u është shtuar si shtojcë kontratave të nënshkruara me koncesionarët dhe të tretët që operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës.

Parimet tona të punës kërkojnë që të gjithë departamentet dhe bizneset në praktikak e punës së tyre të kontribuojnë drejt arritjes së një qëndrueshmërie mjedisore maksimale.

## MENAXHIMI I MBETJEVE

Në përputhje me Planin e Veprimit të Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë dhe Social është zhvilluar dhe zbatuar Koncepti i Menaxhimit të Mbetjeve, që ka për qëllim minimizimin e mbetjeve nëpërmjet riciklimit.



Koncepti i menaxhimit të mbetjeve, bazohet në parimet e mëposhtme:

- minimizimi i mbetjeve
- riciklimi dhe rigjenerimi
- ndalimi i përzjerjes së mbetjeve të ndryshme
- zbatimi i praktikave më të mira të menaxhimit të mbetjeve
- mbledhja, ruajtja dhe transportimi i sigurtë në mbrojtje të mjedisit i mbetjeve, si dhe shkarkimi i tyre në një vend depozitimi të miratuar
- promovimi i një mjedisi pune të sigurt e të shëndetshëm dhe të sigurtë për publikun e gjerë
- mbrojtja e burimeve natyrore
- trajnimi

Llojet e mbetjeve që TIA prodhon klasifikohen në bazë të Katalogut Shqiptar të Mbetjeve, i bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 18.2.2005, "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Mbetjeve". Mbetjet ndahen në mbetje për riciklim dhe mbetje për depozitim.

### Koncepti i TIA-s për menaxhimin e mbetjeve

Terminali i ri u siguron pasagjerëve dhe përdoruesve të aeroportit një sistem për mbetjet e riciklueshme dhe për mbetjet jo të riciklueshme, të përbërë nga tre kosha të veçantë mbetjesh, respektivisht për mbetjet plastike, ato të metalit dhe një për mbetjet e tjera, ndërsa në të gjithë Zonën e Koncesionit janë vendosur kazanë të tillë për mbetjet plastike, metalet, letrën ose kartonat, drurin dhe mbetjet e tjera.

Kompani të specializuara, të licensuara nga autoritetet shqiptare, dhe që operojnë në përputhje me rregullat dhe standardet zyrtare, janë kontraktuar me qëllim që mbetjet e riciklueshme dhe jo të riciklueshme të mblidhen, transportohen dhe më pas të riciklohen ose depozitohen.

Mbetjet dhe substancat e rrezikshme që gjeneron TIA grumbullohen përkohësisht në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar Nr. 9537, datë 18.05.2006, "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme" .

Trajnimi dhe ndërgjegjësimi konsiderohen shumë të rëndësishëm për menaxhimin e duhur të mbetjeve, dhe ky ishte qëllimi që TIA në prill 2007 organizoi seminarin “Menaxhimi i Mbetjeve dhe i Ujit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”. Seminari u organizua me mbështjetjen e HOCHTIEF AirPort dhe të Aeroportit të Düsseldorf-it. Stafi i TIA-s, nënkontraktorët e mirëmbajtjes dhe të sigurisë, koncesionarët e bareve dhe restoranteve morën pjesë në këtë seminar, së bashku me autoritetet e komunës.

Seminari u mbajt për të prezantuar konceptet dhe praktikën në dobi të mjedisit për menaxhimin e mbetjeve dhe trajtimin e ujërave të zeza, që përdoren në aeroporte. Seminari u përqendrua në domosdoshmërinë e hartimit të një programi për pakësimin e mbetjeve, gjë që do të shoqërohet edhe me përfitime ekonomike për TIA. Ky program ka nisur të vihet në zbatim.

## MENAXHIMI I CILËSISË SË AJRIT

Ndotësit kryesorë të ajrit nga aeroporti dhe aktivitetet e tjera që lidhen me të, të cilët mund të ndikojnë në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, janë ozoni, dioksidi i sulfurit dhe oksidet e nitrogenit.

Në përputhje me legjislacionin për mjedisin dhe lejen mjedisore të TIA-s, Aeroporti ka kryer monitorimin e cilësisë së ajrit në Zonën e Koncesionit për sa i takon këtyre ndotësve: PM10, SO<sub>2</sub>, CO, O<sub>3</sub> dhe NO<sub>2</sub>. Monitorimi u krye nga laboratorit i Agjencisë Shqiptare të Pyjeve dhe Mjedisit. Rezultatet treguan që standardet shqiptare dhe ato të Bashkimit Europian, ishin respektuar nga TIA.

## MENAXHIMI I UJIT

Bazuar në procedurat e kërkuara monitoruese të cilësisë së ujit, TIA po siguron mbrojtje dhe ruajtje të ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në përputhje me standardet për ujin dhe parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

### Cilësia e ujit

Me hapjen e terminalit të ri të pasagjerëve TIA furnizohet me ujë të pijshëm nga pusët e rinj të hapur në Zonën e Koncesionit. Uji trajtohet në filtrat e pastrimit të ujit, të vendosur në stacionin e pompave, pranë pusëve të rinj para se të kalojë në ujësjellësin e ri të aeroportit.

Në pranverën e 2007-ës, TIA kreu monitorimin e cilësisë së ujit. Dy kampionë uji u morën dhe u analizuan. Mostra e parë u mor nga depozita kryesore e ujit tek stacioni i pompimit dhe e dyta nga rubinetat e ujit në terminal. Analizat u kryen nga një laborator gjerman, i licensuar.

Parametrat u monitoruan sipas standardeve shqiptare: monitorimi i ujit të pijshëm i referohet Standardeve Shqiptare për Ujin e Pijshëm (STASH 3904:1997), të cilat bazohen në Direktivat e Bashkimit Europian 98/83/EC dhe Standardet e OBSH-së. Rezultatet e analizave treguan se të gjithë parametrat respektonin standardet, me përjashtim të fortësisë së ujit, e cila ishte pak më e lartë se standardi përkatës. Për pasojë, TIA menjëherë mori masat e nevojshme dhe kreu blerjen dhe montimin e një pajisjeje që realizon zbutjen e fortësisë së ujit.

### Ujërat e zeza

Një sfidë e rëndësishme për TIA-n ishte ndërtimi dhe vënia në funksionim e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza. Në përputhje me Marrëveshjen e Koncesionit, Planin e Veprimit të Mjedisit, Shëndetit, Sigurisë dhe Social, TIA ndërtoi dhe, në korrik 2007, vuri në funksionim impiantin e trajtimit të ujërave të zeza të aeroportit. Ujërat e zeza të terminalit të pasagjerëve, të operacioneve dhe të ndërtesave të administratës, si dhe ujërat e zeza të avionëve, mblidhen dhe shkarkohen në impiantin e trajtimit të ujërave të zeza, ku edhe pastrohen mekanikisht dhe biologjikisht para shkarkimit përfundimtar.



Gjatë një periudhe shtatë javore nga fillimi i funksionimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, TIA monitoroi cilësinë e ujërave të zeza. Kampionët u morën në mënyrë periodike dhe u analizuan nga laboratorit i Agjencisë Shqiptare të Pyjeve dhe Mjedisit në Tiranë. Monitorimi i të gjithë parametrave u bë në përputhje me legjislacionin përkatës dhe lejen mjedisore për ndërtimin dhe funksionimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza të miratuar nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujit. Rezultatet e monitorimit shtatë javor treguan se standardet respektohen plotësisht.



Pamje e impiantit të përpunimit të ujërave të zeza

### **Shërbimet e shkrirjes së akullit të avionëve që respektojnë mjedisin**

TIA ofron përdorimin e substancave biologjikisht të degradueshme për shkrirjen e akullit të avionëve. Megjithatë përdorimi i substancave për shkrirjen e akullit në avion është i nevojshëm vetëm pak ditë gjatë stinës së dimrit, TIA përdor substanca që respektojnë mjedisin si për avionët ashtu edhe për zonat e operimeve, duke parandaluar kështu rrezikun e ndotjes së mjedisit. Këto substanca ruhen në mjedis të përshtatshme që respektojnë të gjitha standardet e kërkuara të sigurisë.

## **ZHURMA**

Zhurma e lartë kategorizohet si një ndotës i madh i mjedisit. Për rrjedhojë, motorrët e avionëve janë përmirësuar vazhdimisht që nga fillimi i viteve 1970. Matjet e kryera nga TIA, për nivelet e zhurmave, në janar 2007, treguan se të gjitha aktivitetet në aeroport respektojnë standardet ndërkombëtare. Monitorimi i nivelit të zhurmave u krye nga ekspertë të mjedisit të aeroportit të Hamburgut, Gjermani. Matjet e nivelit të zhurmave u kryen në datat 4 dhe 5 janar, 2007, në përputhje me lejen mjedisore të TIA-s, dhe me legjislacionin shqiptar për mjedisin. Matjet përfshinin tipe të ndryshme avionësh që operojnë në TIA si dhe numrin e lëvizjeve ditore të avionëve. Nivelet maksimale të zhurmës të regjistruara në të dyja ekstremet e pistës varionin nga 62 në 92 dB (A), në varësi të llojit të avionit, me një mesatare ditore prej më pak se 60 dB (A). Konkluzioni i monitorimit dyditor ishte se nivelet e zhurmës në TIA janë në përputhje me legjislacionin evropian.

## MJEDISI NATYROR

### Peizazhi dhe gjelbërimi

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës është angazhuar për promovimin e nismave paraprirëse në ruajtjen e mjedisit të tij natyror. Ai ka zhvilluar e mirëmbajtur peizazhin dhe gjelbërimin në mjediset e tij, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore dhe standardet ndërkombëtare.

Aeroporti ka ngritur dhe kultivuar në pistë një mjedis natyror që synon kushtet operacionale të favorshme për parandalimin e erozionit, zjarreve dhe aksidenteve.

Në këtë kuadër është ndërtuar edhe një sistem i dytë drenazhimi që lidhet me sistemin e ri qendror të drenazhimit.



Pamje e Aeroportit  
Ndërkombëtar të Tiranës

### Kontrolli i faunës së egër

TIA ka hartuar një program për kontrollin e faunës së egër në zonën e operimit të avionëve, duke vënë nën kontroll aktivitetin e zogjve dhe të kafshëve të tjera që mund të shkaktojnë rrezikun e përplasjes së avionëve. Vëzhgim i vazhdueshëm kryhet për të parë praninë e zogjve në aerodrom.



Përmirësime të  
punimeve në  
fushën e aerodromit

## NDËRGJEGJËSIMI DHE TRAJNIMI MBI MJEDISIN DHE CILËSINË

Një ndër faktorët kryesorë që kontribuojnë për një paraqitje sa më të mirë të Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, është procesi i trajnimit. TIA synon sa më shumë trajnime për stafin e saj. Kështu, nevojat e stafit për trajnim identifikohen, planifikohen dhe sigurohen në përputhje me kërkesat e vendeve të punës dhe të përgjegjëseve. Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajnimeve të nevojshme për zbatimin efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe të Cilësisë.

Seminari i parë me temë "Zbatimi i Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Cilësisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës", u mbajt në janar 2007, me synim njohjen dhe sigurimin e një zbatimi efikas të këtij sistemi. Në vazhdim, në prill 2007, u zhvillua seminari me temë "Menaxhimi i Mbetjeve dhe Ujërave të Zeza në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës".

Stafi i TIA-s dhe përfaqësues të palëve të treta kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga ICAO, IATA, ACI me tema të tilla si menaxhimi i materialeve dhe mallrave të rrezikshme, siguria për operacionet e uljes së avionëve, përdorimi dhe mirëmbajtja e mjeteve për shkrimin e akullit të avionëve, ndihma e shpejtë, skuadra e zjarrit dhe ushtrime të emergjencës civile të aeroportit.

## SHËNDETI DHE SIGURIA

TIA ka ngritur Njësinë e Ndhmës së Parë për t'u siguruar një shërbim të shpejtë mjekësor pasagjerëve apo përdoruesve të tjerë të aeroportit. Një detyrë e rëndësishme është ndërgjegjësimi dhe këshillimi i punonjësve lidhur me problemet e shëndetit dhe të sigurisë në punë, për të parandaluar aksidentet dhe sëmundjet profesionale, si dhe të promovojë në përgjithësi çështjen e mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë.

TIA siguron që stafi i saj të jetë i pajisur me Pajisjet Personale të Sigurisë në përputhje me standardet europiane. Si pasojë e punës së vazhdueshme të kompanisë në fushën e shëndetit dhe të sigurisë, në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës, nuk ka pasur raste aksidentesh shqetësuese.

### Gatishmëria dhe Reagimi ndaj Emergjencave

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës ka riparë dhe finalizuar manuale dhe procedura lidhur me sigurinë e operacioneve aeroportuale dhe ka hartuar një Plan të Emergjencave në Aeroport, i cili u aprovua nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil (DPAC) më 23 shkurt 2007.

TIA testoi aftësitë e saj për të përballuar emergjencat gjatë një Ushtrimi për Emergjencat Civile në Aeroport, i zhvilluar me sukses më 14 qershor 2007. Ky testim u krye pas 6 muaj trajnime nga Departamenti i Shpëtimit nga Zjarri, i mbështetur dhe i mbikqyrur nga ekspertët gjermanë të aeroporteve të Dusseldorf-it dhe të Mönchengladbach.


Përfaqësues të qeverisë shqiptare ndoqën ushtrimin, i cili u supervizua nga PAMECA (Misioni i Asistencës për Policinë, i Komunitetit European në Shqipëri) dhe menaxherët e të gjithë shoqërive ajrore që operojnë në aeroport. Në ushtrim u përfshinë edhe shërbimet e shpëtimit nga zjarri dhe të ndihmës së shpejtë, të cilat rezultuan produktive në drejtim të koordinimit të shërbimeve të emergjencës.

Në fund të vitit, një ushtrim i plotë emergjence është planifikuar të zhvillohet në aeroport në bashkëpunim me autoritetet qeveritare.

### Politika kundër duhanit

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës në përputhje me Ligjin Nr. 9636, datë 6/11/2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, ka hartuar një politikë kundër pirjes së duhanit në aeroport, në përputhje me Politikën e Mjedisit, Shëndetit dhe të Sigurisë duke synuar krijimin e një mjedisi miqësor dhe të shëndetshëm për pasagjerët.

TIA po ndjek një politikë strikte kundër duhanit, kudo në terminalin e ri. Megjithatë, ka dy zona të përcaktuara në aeroport, ku lejohet të pihet duhan: një tek veranda e barit, jashtë terminalit të ri dhe tjetra në zonën e nisjes, në një dhomë të veçantë, e projektuar për të mbrojtur personat që nuk pijnë duhan.



## NISMAT SOCIALE

### Projektet sociale dhe komunitare

Në buletinin e parë, TIA informonte lexuesit lidhur me kërkesën për oferta për një plan për zhvillimin e turizmit për komunitetin e Prezës, në fillim të tetorit 2006. Ky projekt, ishte identifikuar nga TIA, si një veprim i vlefshëm për përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve përreth dhe për rritjen ekonomike të zonës. Që nga ajo kohë, është përgatitur një plan nga një firmë britanike konsulence, Goulds Properties UK Limited. TIA investoi 17,000 euro për këtë projekt. Me ndihmën e aeroportit, u organizuan takime mes autoriteteve lokale dhe firmës konsulente, si edhe me ministritë dhe autoritetet përkatëse, për të diskutuar projektin në detaje.



Në brendësi të kështjellës së Prezës

Plani Turistik përfshin disa alternativa për zhvillimin e kështjellës së Prezës dhe të rrethinave të saj, dhe ka si qëllim shndërrimin e zonës në një pasuri me vlerë të madhe kulturore me rëndësi rajonale dhe kombëtare. Së bashku me Krujën dhe Petrelën, ajo do t'i rikthejë rëndësinë kompleksit të tre kështjellave që rrethojnë qytetin e Tiranës. Kështjella e Prezës, me origjinë romane, gjendet në majën e një kodre afër aeroportit dhe është lehtësisht e arritshme nga rruga interurbane Tiranë-Durrës. Në perëndim të fshatit të Prezës, në një vend shumë tërheqës ndodhen dy rezervuarë, luginat rrethuese të të cilëve ofrojnë bukuri dhe qetësi. Ai është një vend i përkryer për aktivitete në natyrë si: udhëtim me kanoa, not, zhytje, peshkim, shëtitje dhe alpinizëm.

Plani i zhvillimit turistik të Prezës iu dorëzua kryetarit të komunës gjatë një ceremonie organizuar në maj 2007, ku morën pjesë përfaqësues të TIA-s dhe të institucioneve qendrore dhe lokale.

### **Takim me autoritetet lokale dhe komunitetin e zonës**

TIA i ka zhvilluar aktivitetet e saj të përditshme me një frymë dialogu të hapur dhe të vazhdueshëm me komunitetin e zonës dhe autoritetet lokale. Siç është përcaktuar në Planin e Mjedisit, Shëndetit e Sigurisë dhe Social, TIA është plotësisht e angazhuar për minimizimin e çdo efekti negativ që mund të shkaktohet nga operacionet, nga zgjerimi i saj në mjedisin dhe komunitetin vendas, si dhe në sigurimin e standardeve mjedisore, shëndetësore, dhe të sigurisë në të gjithë zonat që mund të preken prej saj.

Diskutimet dhe konsultimet me autoritetet lokale kanë nisur që në fillim të periudhës së koncensionit gjatë përgatitjes dhe aprovimit të masterplanit të aeroportit. Këto konsultime janë zhvilluar më tej gjatë përgatitjes së draftit të rregullores mbi miratimin e sheshit të ndërtimit dhe të lejes së ndërtimit brenda zonës së kufizuar dhe zonës së zhvillimit.

Duke e konsideruar si shumë të rëndësishme rritjen e ndërgjegjësimit për çështjet e mjedisit, autoritetet lokale janë ftuar të marrin pjesë në takime dhe trajnime. Për më tepër, përvoja e TIA-s dhe mbështetja e madhe e saj mbi menaxhimin e mbetjeve të Zonës së Koncesionit do të jenë gjithmonë në dispozicion të autoriteteve lokale dhe të gjithë komunitetit pranë aeroportit.



### **Vizitë e fëmijëve në aeroport**

Vizita të udhëhequra nga punonjësit e TIA-s luajnë një rol të rëndësishëm në prezantimin e çështjeve të mjedisit. Në këto vizita, vizitorët kanë mundësi të njihen me praktikën e aeroportit. Në këtë vazhdë, më 22 mars 2007, rreth 250 fëmijë nga shkollat e Tiranës dhe Rinasit, morën pjesë në festimet që shënuan nisjen e fluturimit të parë pas ndërtimit të terminalit të ri.

### Promovimi i fshatit të Prezës

TIA po luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e zonave përreth aeroportit. Në 16 maj 2007, së bashku me ceremoninë e dorëzimit të planit të zhvillimit të turizmit në Prezë, autoritetet lokale në bashkëpunim me TIA hapën një ekspozitë me produkte tradicionale, të prodhuara në Prezë. Fëmijë të zonës, pjesa më e madhe e të cilëve përfaqësonin fshatin e tyre me kostumet popullore, ishin protagonistët e vërtetë të ditës.



Nxënës shkolle i veshur me kostumin tradicional në ceremoninë e zhvilluar në kështjellën e Prezës. Ceremonia, që daton më 16 maj shënoi përfundimin e planit të zhvillimit lokal të turizmit

### Ngjarje të rëndësishme në zonën e aeroportit dhe përreth

#### Përrurimi i terminalit të ri



Prerja e shiritit, më 21 mars 2007, që shënoi hapjen e terminalit të ri në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës. Nga e majta në të djathtë: Z. Michael Granoff, Drejtor i Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, Shkëlqesia e saj ish-Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës Znj. Mercie Rice, Shkëlqesia e tij ish-Ambasadori i Republikës Federale të Gjermanisë Z. Hans Peter Annen, Kryeministri i Shqipërisë Prof. Dr. Sali Berisha, Kryetari i Këshillit Administrativ dhe Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i HOCHTIEF AirPort Dr. Reinhard Kalenda, ish- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i TIA-s, Dr. Constantin von Alvensleben dhe Dr. Michael Bornnman, Anëtar i Bordit Ekzekutiv të DEG



Në ditën pas ceremonisë së hapjes, më 22 mars 2007, terminali i ri nisi funksionimin në praninë e 250 fëmijëve, që ia shtuan atmosferën festive ditës. Operimi në terminalin e ri nisi me fluturimin e parë, në orën 14 e 20 minuta, i një Airbus 319 i linjës Austrian Airlines, që fluturonte nga Tirana për në Vjenë

### Vizita e Presidentit Bush

TIA garantoi uljen dhe ngritjen e sigurtë të njërit prej avionëve më të mëdhenj në botë, një Boeing 747-200B. Me përfundimin me sukses të vizitës së Presidentit Bush, aeroporti shënoi një hap tjetër për arritjen e standardeve europiane, duke treguar që është i aftë të presë avionët më të mëdhenj në botë. Krahas akomodimit të avionit të veçantë dhe të pasagjerëve të tij, TIA ishte e aftë të siguronte operimin normal të 22 fluturimeve të programuara: asnjë fluturim nuk u vonua dhe as u anulua, pavarësisht pranisë së një numri të madh të forcave të sigurimit dhe procedurave të veçanta që duhej të ndiqeshin.



Air Force One, aeroplani zyrtar i Presidentit të SHBA-së i parkuar në pistën e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës më 10 qershor 2007

### Përkujtimorja e Nënë Terezës

Aeroporti, që mban emrin e murgeshës me famë Nënë Tereza, përuroi më 13 shtator 2007 një monument të humanitares së madhe. Monumenti është gjashtë metra i lartë dhe peshon dy tonë.



Monumenti i Nënë Terezës u ngrit më 13 shtator 2007, në mes të rrethrotullimit në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës

## TË DHËNAT KRYESORE

### Viti 2006

Numri i pasagjerëve	906,103
Lëvizjet e avionëve	15,850
Kargo	2,110 tonë
Të dhëna financiare	
Xhiro vjetore	19.5 milionë euro
Të punësuar	
Personeli i aeroportit	afërsisht 230
Personeli i kompanive në aeroport	afërsisht 700
Numri total i të punësuarëve	afërsisht 930

**Kontakt:**

**Znj. Alma Bako**

**Drejto e Departamentit të Cilësisë, Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë**

**E-Mail: [abako@tirana-airport.com](mailto:abako@tirana-airport.com)**

**Tirana International Airport SHPK**

**Tirana International Airport Nënë Tereza**

**Godina e Administratës**

**Rinas, Tiranë**

**Shqipëri**

**Tel: 00355 4 381 600**

**Fax: 00355 4 379 065**

**[info@tirana-airport.com](mailto:info@tirana-airport.com)**

**[www.tirana-airport.com](http://www.tirana-airport.com)**